

GJYKATA SUPREME E KOSOVES

Rasti numer:

Pml.Kzz 236/2016

Gjykata e Apelit rasti nr. PAKR 158/15 Gjykata e
Qarkut te Pri/.renit rasti nr. P 272/13

Data:

11 Janar 2017

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosoves, ne kolegjin e perbere prej Gjyqtares se Gjykates Supreme Valdete Daka (Kryesuese), Gjyqtares se EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova (Raportuese) dhe Gjyqtares se Gjykates Supreme Emine Mustafa, asistuar nga Zyrtarja Ligjore e EULEX- it Maja Mahl ne cilesi te procesmbajteses,

ne rastin penal kunder:

1. **N.U.**, nr. i ID-se xxx, i lindur me xxx, me vendbanim ne xxx;
2. **O.J.**, nr. i ID-se xxx, e lindur me xxx, me vendbanim ne xxx;
3. **S.M.**, nr. i **ID-se** xxx, e lindur **me** xxx, me vendbanim ne xxx;
4. **Sh. Sh.**, nr. i ID-se xxx, e lindur me xxx, me vendbanim ne xxx;
5. **T.M.**, xxx dhe xxx, i lindur me xxx, me vendbanim ne xxx;
6. **E.A.**, nr. i ID-se xxx, i lindur me xxx, me vendbanim ne fshatin xxx;
7. **F.B.**, nr. i ID-se xxx, i lindur me xxx, me vendbanim ne xxx;
8. **Rr.R.**, nr. i ID-se xxx, i lindur me xxx, me vendbanim ne xxx;
9. **H.B.**, nr. i ID-se xxx, e lindur me xxx, me vendbanim ne xxx;
10. **G.G.**, nr. i ID-se xxx, i lindur me xxx, me vendbanim ne xxx;

duke vepruar ne haze te kerkesave per mbrojtjen e ligjshmerise, te parashtruara nga Kryeprokurori Shteteror, T.M., O.J., Sh. Sh. dhe avokati mbrojtjes V.V ne emer te S.M.;

pas shqyrtimit te pergjigjeve te parashtruar nga Kryeprokurori Shteteror, T.M., O.J., E.A., Rr.R. dhe avokatet mbrojtës te S.M.t dhe R.R.;

pasi qe kane pleqeruar dhe votuar me 11 janar 2017;

sipas neneve 418 dhe 432—441, 384 (1.12) dhe 370 te Kodit te Procedures Penale (ne tekstin e metejme: KPP);

nxjerre kete

AKTGJYKIM

- I. Kerkesa per mbrojtjen e ligjshmerise, e parashtruar nga Kryeprokurori Shteteror, ndaj aktgjykimit te Gjykates se Qarkut te Prizrenit te dates 9 shtator 2014, ne rastin nr. P 272/13, dhe ndaj aktgjykimit te Gjykates se Apelit te dates 5 prill 2016, ne rastin nr. PAKR 158/15, aprovohet si ne vijim: Gjykata Supreme percakton se aktgjykimi i Gjykates se Apelit i dates 5 prill 2016, ne rastin nr. PAKR 158/15, ne pjesen Iiruese lidhur me **N.U., E.A.n, F.B.n dhe Rr.R.n**, ligji eshte shkelur ne favor te te pandehurve
- II. Kerkesat per mbrojtje te ligjshmerise, te parashtruara nga **T.M., O.J., Sh. Sh.dhe avokati mbrojtës V.V. ne emer te S.M.t**, ndaj aktgjykimit te Gjykates se Qarkut te Prizrenit te dates 9 shtator 2014, ne rastin nr. P 272/13 dhe ndaj aktgjykimit te Gjykates se Apelit te dates 5 prill 2016, ne rastin nr. PAKR 158/15, jane refuzuar si te pabazuara.

L HISTORIKU PROCEDURAL PERKATES

1. Me 27 korrik 2012, Prokuroria Speciale e Republikes se Kosoves (ne tekstin e metejme: Prokurori) ngriti Aktakuzen PPS 253/09 kunder te pandehurve te lartpermendur.
2. Seancat degjimore te konfirmimit jane mbajtur me 30 gusht 2012, 24 shtator 2012, 18 tetor 2012 dhe 2 nentor 2012. Lenda e **F.B.t dhe T.M.** jane ndare nga rasti me 24 shtator 2012. Sa i perket **T.M.** lenda eshte ri-bashkuar me 18 tetor 2012.
3. Me 27 dhjetor 2012, aktakuza eshte hedhur poshte nga nje aktvendim i leshuar nga gjyqtari i procedures paraprake. Prokurori parashtroi ankese ndaj aktvendimit. Ne nje aktvendim te dates 17 prill 2013, Gjykata e Apelit e aprovoi pjeserisht ankesen dhe vendosi qe aktakuza, subjekt i ndryshimeve, mbetet ne fuqi. Aktakuza per te gjithë te pandehurit eshte hedhur poshte per aq s i referohet kualifikimeve ligjore te Keqperdorimit te Pozites Zyrtare.

4. Sa i perket **F.B.**, lenda eshte ri-bashkuar me 22 gusht 2013. Aktakuza ndaj tij eshte konfirmuar me nje aktvendim te dates 5 dhjetor 2013, i cili aktvendim eshte konfirmuar nga Gjykata e Apelit.
5. Shqyrtimi gjyqesor filloi me 21 janar 2014 dhe perfundoi me 4 shtator 2014. Me 22 janar 2014, eshte parashtruar nje aktakuze e ndryshuar.
6. Me 9 shtator 2014, Gjykata e Qarkut e shpalli aktgjykimin e saj, permes te cilit:
 - a. **N.U.** eshte shpallur fajtor per vepren penale te Nxjerrjes se Kunderligjshrne te Vendimit Gjyqesor, te kryer ne bashkekryerje, ne haze te neneve 346 dhe 23 te Kodit te Perkohshem Penal te Kosoves (ne tekstin e metejme: KPPK).
 - b. **O.J., E.A., F.B., Rr.R., Sh. Sh.dhe T.M.** jane shpallur fajtores per vepren penale te Nxjenjes se Kunderligjshme te Vendimit Gjyqesor, ne haze te nenit 346 te KPPK-se.
 - c. **H.B.** eshte shpallur fajtores per vepren penale te Ndhimes ne Nxjerrjen e Kunderligjshme te Vendimit Gjyqesor, ne baze te neneve 346 dhe 25 te KPPK- se.
 - d. **G.G.** eshte shpallur fajtor per vepren penale te Falsifikimit te Dokumenteve, ne baze te nenit 332 te KPPK-se.
 - e. Te gjitha te pandehurit jane denuar me kusht, perbere nga denimet me burgim ne kohezgjatjet vijuese: **N.U.** - dy vjet, **O.J.** - tetembdhjete muaj, **E.A.** - nente muaj, **F.B.** - nente muaj, **S.M.** - gjashte muaj, **Sh. Sh.**- tete muaj, **T.M.** - nje vit, **Rr.R.** - nente muaj, **H.B.** - nje vit, dhe **G.G.** - gjashte. muaj.
 - f. Ndeshkimi shtese i ndalimit te ushtrimit te profesionit, aktivitetit apo detyres u eshte shqiptuar te gjitha te pandehurve.
7. Aktgjykimi i Gjykates se Qarkut eshte ankimuar nga Prokurori dhe te pandehurit. Gjykata e Apelit e nxori aktgjykimin e saj me 5 prill 2016. Me kete aktgjykim, aktgjykimi i Gjykates se Qarkut eshte modifikuar siq vijon:
 - a. **N.U., E.A., F.B., Rr.R.** dhe **G.G.** i jane liruar.
 - b. Denimet e **O.J., S.M.t, Sh.Sh.** dhe **T.M.** kane mbetur ne fuqi, por me modifikimin qe te pandehurit e kane kryer vepren penale me qellimin e shkaktimit te demit ndaj personave tjere.
 - a. Ndeshkimet shtese ndaj **O.J., S.M.t, Sh.Sh., T.M. dhe H.B.t** jane modifikuar ne lidhje me dispozitat e referuara dhe me qartësimin që ndalimet do të fillojnë nga dita kur aktgjykimi të merr formë të prerë.
8. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë parashtruar nga: **T.M.** më 29 qershor 2016, **O.J.** më 29 qershor 2016, **Sh.Sh.** më 25 korrik 2016, avokati mbrojtës **V.V.** në emër të **S.Sh.** më 22 gusht 2016, dhe nga Kryeprokurori Shtetëror më 15 gusht 2016.
9. Kërkesat e lartpërmendura u janë dorëzuar palëve kundërshtuese. **T.M., O.J., E.A., Rr.R.,** avokatët mbrojtës të **S.M. dhe Rr.R.**, si dhe Kryeprokurori Shtetëror i kanë parashtruar përgjigjet e tyre.

II. KËRKESAT PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË

Kryeprokurori Shtetëror

Kryeprokurori Shtetëror kërkon nga Gjykata Supreme që të përcaktoj se aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës së Apelit janë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale sipas neneve 384 (1.12) dhe 370 (7) të KPP-së, dhe në shkelje të ligjit penale sipas nenit 385 (1.5) të të njëjtit kod. Ai deklaron:

Shkelja e Nenit 370 të KPP-së:

Aktgjykimet janë përpiluar në shkelje të nenit 370 (7) të KPP-së, për shkak se: Gjykata e Qarkut erdhi në konkluzionin e gabuar kur e përcaktoi veprën penale të kryer nga **G.G.**. Ai nuk pajtohet me konkluzionin e Gjykatës së Apelit, që provat janë të pamjaftueshme që të përcaktojnë që **G.G., E.A., F.B., Rr.R. dhe N.U.** të shpallen fajtorë. Gjykata e Apelit nuk e bëri një vlerësim të besueshmërisë së provave, dhe as që kolegji ka prezantuar arsye të qarta për vendosjen e çështjeve faktike dhe ligjore. Është e paqartë sesi kolegji në njërën anë gjeti se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut është i drejtë, por në anën tjetër e modifikoi atë dhe i liroi di sa nga të pandehurit. Nuk është e mundshme që ta lexosh aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe ti kuptosh arsyet për dispozitiv.

Shkelja sipas nenit 385 (1.5) të KPP-së:

Aktgjykimet janë në shkelje të ligjit penal sipas nenit 385 (1.5) të KPP-së, për shkak se ndëshkimet e shqiptuara nuk përputhen me peshën e veprave penale dhe për shkak se shqiptimi i dënimeve me kusht është i papërshtatshëm kur marrim parasysh karakterin e rëndë të veprave penale.

T.M.

T.M.kërkon nga Gjykata Supreme që ti modifikon aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës së Apelit, dhe ta liron atë nga akuza, ose të vendos për alternativën tjetër të anulimit të aktgjykimeve dhe ta kthej rastin në rigjykim. Ai argumenton që aktgjykimet janë në shkelje të nenit 346 të KPPK-së dhe në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 (1.3) të KPP-së. Ai deklaron:

Shkelja e ligjit material penal:

Ligji penal është shkelur në dëm të tij për shkak se ai është shpallur fajtor edhe nëse elementet e paraqitura në nenin 346 të KPPK-së nuk kanë ekzistuar. Vepra penale e Nxjerrjes së Kundërligjshme të Vendimit Gjyqësor mund të kryhet vetëm me qëllim të drejtpërdrejt. Gjatë procedurës nuk është dëshmuar qëllimi i drejtpërdrejt. Ai e ka nxjerrë vendimin në përputhje me ligjin në fuqi dhe nuk ka pasur për qëllim sigurimin e përfitimit të dobisë pasurore për veten ose për personin tjetër apo të shkaktoj dëm. Përveç kësaj,

Gjykata e Apelit e ka zbatuar ligjin në mënyrë selektive kur kolegji, edhe pse rrethanat faktike ishin të pandryshuara, i ka liruar vetëm gjyqtarët e shkallës së dytë.

Shkelja sipas nenit 384 (1.3) të KPP-së:

Në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Qarkut e mbajti një seancë pjesërisht në mungesë të një të pandehuri. Kjo ndodhi më 3 shtator 2014, kur i pandehuri **F.B.** është lejuar të largohet nga seanca para se ajo të përfundoj, për shkak të problemeve shëndetësore. Prania e të pandehurit ishte e obligueshme dhe Gjykata e Qarkut është dashur ta ndajë lëndën kundër tij, por ka dështuar ta bëjë këtë. Kjo ankesë është hedhur poshtë nga Gjykata e Apelit për shkak se nuk është përmendur në procesverbal. Procesverbali nga seanca nuk i janë dorëzuar kurrë atij dhe për këtë ai nuk ka qenë në dijeni për këtë lëshim derisa e ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme mund ta përcaktoj se çfarë ka ndodhur gjatë seancës duke e analizuar video dhe audio-incizimin nga ajo seancë.

O.J.

O.J. kërkon nga Gjykata Supreme që ti modifikon aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës së Apelit, dhe ta liron atë nga akuza. Ajo pohon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është në shkelje të nenit 346 të KPPK-së për shkak se arsyetimi nuk përmend asnjë provë që dëshmon se ajo kishte për qëllim të shkaktoj dëm. Ajo potencon se një aktgjykim i fajësisë nuk mund të jetë rezultat i asaj çfarë besojnë gjyqtarët, por duhet të jetë i bazuar në prova, dhe se aty nuk ka prova që jo kishte për qëllim të shkaktoj dëme. Përveç kësaj, ajo argumenton se Gjykata e Apelit e ka zbatuar ligjin në mënyrë selektive pasi që vetëm gjyqtarët e shkallës së dytë, të cilët e konfirmuan vendimin e shkallës së parë, janë liruar, përderisa dënimet e gjyqtarëve të shkallës së parë kanë mbetur në fuqi.

S.M.

Avokati mbrojtës i **S.M.** kërkon nga Gjykata Supreme që ti anulon aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës së Apelit, dhe ta kthej rastin në rigjykim. Sipas nenit 435 (4) të KPP-së, ai kërkon që Gjykata Supreme të urdhëroj që zbatimin e aktgjykimeve të shtyhet apo të ndërpritet. Kërkesa bazohet në shkeljet e dispozitave të procedurës penale, ligjit penal dhe Kushtetutës, me sa vijon:

Shkeljet e dispozitave të procedurës penale:

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut është në shkelje të nenit 370 të KPP-së për shkak se: Dispozitivi nuk është i qartë në lidhje me ndëshkimin e shqiptuar shtesë sepse nenet e referuara nuk e rregullojnë ndalesën e përmendur. Dispozitivi është në kundërshtim me vetveten dhe arsyetimin pasi që **N.U.** ishte i vetmi nga të pandehurit i cili është dënuar për veprën penale në bashkëkryerje me të tjerët. Dispozitivi rrjedhë nga keqinterpretimi i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore sepse është deklaruar gabimisht se të pandehurit i

kanë anuluar kontratat, përderisa nga këndvështrimi ligjor ajo vetëm e ka konfirmuar anulimin e tyre. Arsyetimi nuk i adreson argumentet e ngritura në deklaratën e tij përfundimtare. Nuk është dhënë asnjë arsye në lidhje me përcaktimin e fakteve materiale. Arsyetimi është kontradiktor me provat për shkak se është përcaktuar gabimisht se **S.M.** i ka proceduar dy raste të tokës në vend të një, dhe se ajo i ka lëshuar vendimet me qëllimin për të siguruar një përfitim të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo për personin tjetër. Qëllimi nuk është mbështetur nga asnjë provë e vetme. Qëllimi duhet të përcaktohet me prova, dhe nuk mund që, siç gabimisht ceket në aktgjykim, të nxirret nga provat rrethore.

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është gjithashtu në shkelje të Nenit 370 të KPP-së për shkak se: Të gjitha mangësitë e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të përmendura më lart, janë konfirmuar. Arsyetimi është i pakuptueshëm; nuk është e mundshme që ta lexosh aktgjykimin dhe ta kuptosh se përse është dënuar e pandehura. Nuk është cekur në çfarë mënyre është kryer vepra penale apo nëse aktgjykimet e kontestuar mund të rishikohen apo jo, kur ato aktgjykime ende gjenden në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme. Dispozitivi nuk është i qartë pasi që nuk është dhënë asnjë specifikë në cilat pjesë të ankesës që janë miratuar apo hedhur poshtë. Vetëm dënimi është konfirmuar, domethënë që Gjykata e Apelit e ka konfirmuar dënimin, por jo fajësinë. Gjykata e Apelit ka përcaktuar gabimisht se **S.M.**, me dijeni të plotë ka nxjerrë vendime të kundërligjshme dhe se ajo është marrë me dy raste.

Gjykata e Qarkut ka shkelur dispozitat tjera të procedurës penale, me si vijojnë: Më 3 shtator 2014, i pandehuri **F.B.** – pranë e të cilit gjatë seancave ishte e obligueshme – është dërguar në spital. Në vend të ndërprerjes së seancës, Gjykata e Qarkut e vazhdoi seancën në mungesë të **F.B.**. Përveç kësaj, Gjykata e Qarkut ka falsifikuar prova. Në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut deklarohet gabimisht se AKM-së nuk i është dorëzuar asnjë njoftim, kur në fakt njoftimi gjendej në dosje të rastit dhe ishte i listuar në aktakuzë. Gjykata e Apelit e përsëriti veprimin e Gjykatës së Qarkut për falsifikimin e provave.

Shkeljet e Kushtetutës:

Neni 104 (5) i Kushtetutës përshkruan se pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat. Kjo domethënë se vetëm gjykatat më të larta kanë autoritetin që të rishikojnë një vendim gjyqësor të nxjerrë nga një gjykatë e shkallës më të ulët. Për ta mbrojtur këtë parim, neni 107 i Kushtetutës garanton imunitetin për gjyqtarët. Në shkelje të këtyre parimeve të mbrojtura me Kushtetutë, përfundimi i këtij rasti i jep prokurorit autoritetin për të rishikuar vendimet gjyqësore dhe vendos një presion të lartë mbi gjyqtarët e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, aty ku vendimet kontestuese janë pezull.

Shkeljet e ligjit penal:

Aktgjykimet janë në shkelje të ligjit penal për shkak se nuk është përcaktuar qëllimi i drejtpërdrejt. Vepra penale e Nxjerrjes së Kundërligjshme të Vendimit Gjyqësor mund të

kryhet vetëm me qëllim të drejtpërdrejt. Në këtë rast kontestohet se **S.M.** nuk ka siguruar ndonjë përfitim të kundërligjshëm për vete dhe se nuk është shkaktuar ndonjë dëm. Rrjedhimisht, nuk mund të përcaktohet qëllimi i drejtpërdrejt. Aktgjykimet gjithashtu shkelin ligjin penal sepse ndëshkimi shtesë është i kundërligjshëm pasi që vendimet e kontestuara janë pezull në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe për shkak se është i padrejtë dhe degradues për një gjyqtare.

Sh.Sh.

Sh.Sh. kërkon nga Gjykata Supreme që ti modifikon aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës së Apelit, dhe ta liron atë nga akuza, ose të vendos për alternativën tjetër të anulimit të aktgjytimeve dhe ta kthej rastin në rigjykim. Sipas nenit 435 (4) të KPP-së, ajo kërkon që Gjykata Supreme të urdhëroj që zbatimi të shtyhet apo të ndërpritet. Duke iu referuar një numri të dokumenteve të përfshira në dosje të rastit, ajo pohon se aktgjykimet janë në shkelje të dispozitave të procedurës penale, ligjit penal dhe Kushtetutës, me sa vijon:

Shkeljet e dispozitave të procedurës penale:

Aktgjykimet janë përpiluar në shkelje të nenit 370 të KPP-së, për shkak se arsyetimi nuk i përfshinë të gjitha informatat e nevojshme të specifikuar në nenin 365 të të njëjtit kod. Nga aktgjykimet nuk bëhet e ditur se përse ajo është shpallur fajtor. Dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, i cili është konfirmuar nga Gjykata e Apelit, nuk e specifikon mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe as faktet dhe rrethanat që e tregojnë natyrën kriminale të aktit të kryer. Përveç kësaj, dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nuk e specifikon se cilat pjesë të ankesës që janë miratuar apo hedhur poshtë. Sipas dispozitivit nuk është kryer asnjë vepër penale, por prapëseprapë ndëshkimi është konfirmuar.

Vendimi i kontestuar, i nxjerrë nga ajo, nuk mund të rishikohet pasi që është konfirmuar nga një gjykatë e shkallës së dytë. Konfirmimi bazohej në ligjin në fuqi të asaj kohe. Nga perspektiva ligjore, nuk është e mundur që një vendim gjyqësor që është konfirmuar nga shkalla e dytë, të konsiderohet i kundërligjshëm. Kur një vendim gjyqësor konfirmohet nga një gjykatë më e lartë, përgjegjësia bie ekskluzivisht në kolegjin e gjykatës më të lartë.

Janë fshehur dhe manipuluar prova në dëm të saj, për shkak se në aktgjytime është cekur se AKM-së nuk i është dorëzuar asnjë njoftim mbi pretendimin, përkundër faktit që njoftimi është i përfshirë në dosje të rastit dhe gjendet i listuar në aktakuzë.

Shkeljet e ligjit penal:

Aktgjykimet janë në shkelje të ligjit penal për shkak se nuk është përcaktuar dhe as që ka mundur të përcaktohet qëllimi i drejtpërdrejt. Vepra penale e Nxjerrjes së Kundërligjshme të Vendimit Gjyqësor mund të kryhet vetëm me qëllim të drejtpërdrejt. Në rastin aktual, është e pakontestueshme se ajo nuk siguroi kurrfarë përfitimi të

kundërligjshëm të dobisë pasurore dhe se nuk i është shkaktuar kurrfarë dëmi ndonjë pale të tretë, pasi që aktgjykimi i saj nuk ka rezultuar me asnjë ndryshim në regjistrin e pronësisë. Përveç kësaj, pasi që vendimi gjyqësor i nxjerrë nga ajo ishte vetëm konfirmues për nga natyra, ai nuk ka mundur të rezultoi me obligime apo dëme. Për shkak të këtyre rrethanave, nuk mund të përcaktohet qëllimi i drejtpërdrejt. Gjykatat, sa i përket kësaj, i kanë bazuar konkluzionet e tyre thjesht në bazë të supozimeve.

Aktgjykimet janë gjithashtu në shkelje të ligjit penal, për shkak se ndëshkimi shtesë është i kundërligjshëm dhe degradues për një gjyqtare.

Shkeljet e Kushtetutës:

Aktgjykimet shkelin parimin e mbrojtur Kushtetues të imunitetit për xxx, sipas nenit 107 të Kushtetutës, pasi që ato e privojnë gjyqtarin nga e drejta që në mënyrë të pavarur të nxjerrë aktgjykime të bazuara në ligjin në fuqi, pikëpamjen e tij/saj gjyqësore personale dhe vlerësimin e provave. Gjyqtari nuk duhet që të jap përgjegjësi penale për vendime gjyqësore të nxjerra brenda përgjegjësisë së tij/saj si gjyqtar. Vetëm një gjykatë e shkallës më të lartë ka autoritetin që të vlerësoj kualitetin e performancës dhe profesionalizmit të një gjyqtari. Përveç kësaj, fakti që xxx e shkallës së dytë janë liruar përderisa ajo është dënuar, është shembull i qartë i drejtësisë selektive, dhe tregon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është diskriminues, i padrejtë, jo i plotë, i anshëm dhe i kundërligjshëm.

10. III. PERGJIGJET

11. Pergjigja nga Kryeprokurori Shteteror

12. Kryeprokurori Shteteror kerkon nga Gjykata Supreme ti hedh poshte kerkesat e parashtruara nga te pandehurit, si te pabazuara. Ai argumenton se kerkesat nuk permbajne asnje fakt qe nuk eshte marre parasysh tashme nga gjykatat, dhe pajtohet me aktgjykimet ne pjeset qe jane sfiduar nga te pandehurit.

13. Pergjigjet nga te pandehurit

14. **T.M., O.J., E.A., Rr.R.**, avokati i tij mbrojtës dhe avokati mbrojtës **V.V.** ne emer te **S.M.t.**, kerkojne nga Gjykata Supreme qe ta hedhin poshte kerkesen e parashtruar nga Kryeprokurori Shteteror, si te pabazuara. **T.M., O.J.** dhe avokati mbrojtës **V.V.**, i referohen argumenteve te paraqitura ne kerkesat e tyre per mbrojtje te ligjshmerise. **E.A., Rr.R.** dhe avokati i tij mbrojtës i referohen argumenteve te paraqitura ne ankesat e tyre ndaj aktgjykimit te Gjykeses se Qarkut, dhe te gjeturave te Gjykeses se Apelit.

IV. TE GJETURAT E GJYKATES SUPREME

Kompetenca dhe Perberja e Kolegjit

1. Sipas neneve 21 dhe 22 te Ligjit mbi Gjykatat nr. 03/L-199, Gjykata Supreme eshte gjykate kompetente per te gjykuar mbi kete geshtje.
2. Sipas Ligjit mbi Gjykatat nr. 03/L-199 dhe Ligjit mbi Juridiksionin, Perzgjedhja e Lendeve dhe Caktimin e Lendeve te Gjyqtareve dhe Prokuroreve te EULEX-it ne Kosove nr. 03/L-053, i ndryshuar nga Ligjet nr. 04/L-273 dhe 05/L-103, lenda konsiderohet si nje "Lende ne procedure". Rrjedhimisht, gjyqtaret e EULEX-it kane juridiksionin dhe kompetencen ne kete rast, dhe Kolegji perbehet prej nje shumice te gjyqtareve vendor dhe kryesohet nga nje gjyqtare vendore.

Ligjet ne fuqi

3. Procedura e Gjykates Supreme udhehiqet nga KPP-ja, per shkak se kerkesat per mbrojtje te ligjshmerise jane parashtruar pasi qe KPP-ja ka hyre ne fuqi me 1 janar 2013 (neni 539 i KPP-se).
4. Sig eshte percaktuar dhe arsyetuar si duhet nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata e Apelit, KPP-ja ka qene gjithashtu ligji procedural ne fuqi ne proceduren penale ne lidhje me meritat e kerkesave, dhe KPPK (*Kodi i Perkohshem Penal i Kosoves*) eshte ligji thelbesor ne fuqi ne lidhje me akuzat.

Pranueshmeria

5. Kerkesat jane te pranueshme pasi qe ato jane parashtruar nga personat e autorizuar, kunder aktgjykimeve perfundimtare, dhe brenda afateve te caktuara kohore (neni 433 i KPP-se).

Meritat e Kerkesave

6. Sipas nenit 436 (1) te KPP-se, kolegji e ka kufizuar veten ne ekzaminimin e atyre shkeljeve qe palet qe kane parashtruar kerkesa, i kane paraqitur ne kerkesat e tyre. Te gjeturat e kolegjit jane te strakturuara si ne vijim: Se pari, pretendimet e ngritura nga Kryeprokurori Shteteror do te adresohen nje nga nje ne paragrafet 7—17. Ne paragrafet 18—34, kolegji pastaj do ti adresoj pretendimet e ngritura nga te pandehurit. Pasi qe disa pretendime jane ngritur nga me shume se nje prej te pandehurve, kolegji ka vendosur per ti straktuar te gjeturat e tij duke u bazuar ne vet pretendimet ne vend te se ti adresohet kerkesave nje nga nje.

Kerkesa e Kryeprokurorit Shteteror

Permbajtja e aktgjykimeve:

7. Kryeprokurori Shteteror kerkon nga Gjykata Supreme qe te percakton se aktgjykimet jane ne shkelje thelbesore te procedures penale, sipas nenit 384 (1.12) te KPP-se, uhuar ne nderlidhje me nenin 370 (7) te te njejtit kod. Per arsyet e paraqitura me poshte, kolegji ka konkluduar se ky pretendim eshte pjeserisht i mire-bazuar.
8. Fillimisht, kolegji duhet ta adresoj fusheveprirnin e shqyrtimit te tij, pasi qe kerkesa perfshin argumente qe nuk lejohen si baza per kerkesa per mbrojtje te ligjshmerise siç parashikohet ne KPP. Neni 432 (2) i KPP-se qartazi e pershkruan qe nje kerkese per mbrojtje te ligjshmerise nuk mund te parashtrohet mbi bazen e percaktimit te gabuar apo jo te plote te situates faktike. Ky kufizim i ndalon te gjitha argumentet qe - drejtperdrejt apo jo drejtperdrejt - e sfidojne percaktimin faktik. Per shkak te ketij kufizimi, kolegji nuk mund ti vleresoj argumentet ne lidhje me percaktimin e fakteve. Per kete, keto argumente hidhen poshte si te pabazuara sipas nenit 437 te KPP-se.
9. Neni 370 (7) i KPP-se e rregullon formen dhe permbajtjen e aktgjykimit te shkruar ne lidhje me vleresimin faktit te gjykates. Ai parashikon kerkesat minimale te arsyetimit te gjykates dhe ofron nje garanci procedurale qe gjykata, ne aktgjykimin e saj, jep shpjegime te qarta dhe detajuara per konkluzionet e veta. Neni 370 (7) i KPP-se thote:

Gjykata paraqet qarte dhe ne menyre te plote se cilat fakte dhe per gfare arsyeshe i konsideron te vertetuara apo te pavertetuara. Gjykata gjithashtu, ne menyre te vegante vlereson sakesine e provave kunderthenese, arsyet e mosmiratimit te propozimit konkret te paleve, si dhe arsyet ne te cilat eshte bazuar me rastin e zgjidhjes se geshtjeve juridike, veganerisht me rastin e vertetimit te ekzistimit te vepres penale dhe pergjegjesise penale te te akuzuarit, si dhe me rastin e zhatimit te dispozitave te caktuara te ligjit penal ndaj te akuzuarit dhe vepres se tij/saj.

10. Sa i perket argumenteve qe nderlidhen me permbajtjen e aktgjykimit te Gjykates se Qarkut, kolegji gjen se pretendimet jane te pabazuara. Kolegji ve ne dukje se Gjykata e Qarkut i ka adresuar qarte dhe ne menyre te detajuar te gjitha elementet e akuzes kunder **G.G.** it ne paragrafet 342—353 te aktgjykimit te saj, dhe se Gjykata e Apelit kryesisht i ka ritheksuar keto konkluzione ne faqet 30 dhe 31 te aktgjykimit te saj. Kolegji konkludon se aktgjykimi i Gjykates se Qarkut i ploteson kushtet e paraqitura ne nenin 370 (7) te KPP-se. Per kete arsye, pretendimet ne kete aspekt, jane te pabaza.
11. Sa i perket argumenteve qe nderlidhen me permbajtjen e aktgjykimit te Gjykates se Apelit, kolegji pajtohet me Krveprokurorin Shteteror, dhe gjen se aktgjykimi nuk i

ploteson kushtet e paraqitura ne nenin 370 (7) te KPP-se, ne pjeset permes te cilave **N.U., E.A., F.B. dhe Rr.R.** jane shpallur te pafajshem. Ne keto pjese, kolegji fillimisht vuri ne dukje qe Gjykata e Apelit, ne faqen 26 te aktgjykimit te saj, konkludon se Gjykata e Qarkut arrin ne konkluzionet logjike ne vleresimin e provave, dhe se nuk ka gjetur asnje arsye per te dyshuar se nuk eshte percaktuar si duhet fakti material apo qe Gjykata e Qarkut e ka interpretuar ndonje prove ne menyre te gabuar. Duke e pasur kete ndermend, kolegji gjen se arsyetimi pasues permes te cilit **N.U., E.A., F.B. dhe Rr.R.** jane shpallur te pafajshem, eshte i pakapshem.

12. Në lidhje me **E.A., F.B. dhe Rr.R.**, kolegji gjen se Gjykata e Apelit ka dështuar të paraqes arsye të qarta se përse vlerësimi i saj sa i përket qëllimit ka dalluar ndërmjet gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të dytë. Nga arsyetimi në këtë pjesë, nuk është shpjeguar se përse ishin me rëndësi numri i rasteve apo fakti që “ankesa tashmë u ishte drejtuar atyre”. Kolegji konkludon se nuk është e mundur ta lexosh aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe ti kuptosh arsyet për lirimin e këtyre të pandehurve.

13. Në lidhje me **N.U.**, kolegji gjen se Gjykata e Apelit ka dështuar ta adresoj provën kyçe të adresuar nga Gjykata e Qarkut, siç ishte përgjigja e **N.U.**, es ndaj letrës së AKM-së pranuar në janar të vitit 2007, përfshirjen e tij të drejtpërdrejt në rastin nr. 2333/05 dhe komunikimin e tij me zyrën e AKM-së. Në kuptim të kësaj, kolegji nuk e kupton konkluzionin se “prokuroria ka dështuar të paraqes ndonjë provë që e lidh të pandehurin **N.U.**, përveç rrolit të tij zyrtar dhe të përgjithshëm si xxx, me të pandehurit [...]”. Gjithashtu në këtë pjesë, kolegji konkludon se nuk është e mundur që ta lexosh aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe ti kuptosh arsyet për lirimin e **N.U.**

14. Sipas nenit 384 (1.12) të KPP-së, ekziston një shkelje thelbësore e dispozitave të procedurës penale nëse aktgjykimi nuk është përpiluar në përputhje me nenin 370 të të njëjtit kod. Në paragrafët e mësipërm 11—13, kolegji ka konkluduar se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit pjesërisht nuk është përpiluar në përputhje me nenin 370 (7) të KPP-së, siç është përshkruar më lart në mënyrë të duhur. Për shkak të kësaj, kërkesa e Kryeprokurorit Shtetëror është pjesërisht e mirë-bazuar. Sipas neneve 438 (1.3) dhe (2) të KPP-së, kolegji e përcakton këtë shkelje, por nuk ndërhyr në vendimin përfundimtar.

Shqiptimi i ndëshkimeve:

15. Kryeprokurori Shtetëror kërkon nga Gjykata Supreme që të përcakton se aktgjykimet janë në shkelje të ligjit penal sipas nenit 385 (1.5) të KPP-së. Për

arsyet e paraqitura më poshtë, kolegji ka konkluduar se shkeljet e pretenduara nuk ekzistojnë.

16. Fillimisht, kolegji vë në dukje se argumentet e paraqitura nga Kryeprokurori Shtetëror nuk ndërlidhen me dispozitat e referuara apo shkeljen e pretenduar. Neni 385 (1.5) i KPP-së përshkruan se shkelja e ligjit penal ekziston nëse gjykata e tejkalon autoritetin e saj sipas ligjit në nxjerrjen e vendimeve të caktuara. Në lidhje me vendimin mbi ndëshkimin, gjykata e tejkalon autoritetin e saj sipas ligjit, nëse e shqipton një dënim që nuk është i përshkruar për veprën penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor. Nëse gjykata vepron brenda autoritetit të saj, nuk ekziston ndonjë shkelje e ligjit penal sipas nenit 385 (1.5) të KPP-së. Për këtë, thjesht një deklaratë se ndëshkimet e shqiptuara nuk e pasqyrojnë peshën e veprave penale, nuk është shkelje e ligjit penal në kuptim të nenit 385 (1.5) të KPP-së.

17. Kolegji e ka ekzaminuar në mënyrë të detajuar nëse gjykatat i kanë tejkualuar autorizimet e tyre me rastin e denimit të pandehurve, dhe konkludon se gjykatat rindokojnë dhe kanë bërë një gjë të tillë. Sipas nenit 346 të KPPK-së (*Kodit të Perkozhshëm Penal të Kosovës*) vepra penale e Nxjerrjes së Kunderligjshme të Vendimeve Gjyqësore denohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet. Të gjitha denimet me burgim janë vendosur brenda kësaj kornize. Sa i përket shqiptimit të denimeve me kusht, janë në fuqi nenet 41—44 të KPPK-së. Këto dispozita përshkruajnë që denimi me kusht mund të shqiptohet për veprat penale të denueshme me burgim deri në pesë vjet. Gjithashtu në lidhje me këtë, gjykatat kanë vepruar brenda autorizimeve të tyre. Për këtë, pretendimi se gjykatat i kanë tejkualuar autorizimet e tyre është i pabazuar.

Kerkesat e te Pandehurve

Percaktimi i qellimit:

18. Pretendimet në lidhje me percaktimin e qellimit janë ngritur nga **T.M., O.J., S.M. dhe Sh.Sh.** Thënë shkurt, ata argumentojnë se neni 346 i KPPK-së është shkelur në dem të tyre për shkak se nuk është deshmuar apo percaktuar qellimi i drejtperdrejt dhe për shkak se qellimi nuk mund të nxirret nga pro vat rrethanore. Për arsyet e paraqitura më poshtë, kolegji ka konkluduar se këto argumente janë të pabazuara. Në pari, megjithatë duhet të potencohet se kolegji nuk mund të vlerësojë percaktimin

faktik nga gjykatat, pasi qe kjo nuk bie ne fusheveprimin e shqyrtimit te tij, si? pershkruset dhe shpjegohet me lart ne paragrafin 8. Ne vijim, kolegji per kete do ta vleresoj ekskluzivisht nese eshte shkelur apo jo ligji penal material dhe jo nese gjykatat i kane percaktuar apo jo faktet, si duhet.

19. Fillimisht, kolegji pajtohet plotesisht me Gjykatën e Qarkut sa i perket pershkrimin te elementeve te vepres penale te Nxjerrjes se Kunderligjshme te Vendimit Gjyqesor sipas nenit 346 te KPPK-se (paragrafet 222—242 te aktgjykimit te Gjykates se Qarkut). Kolegji nuk e ka per qellim qe ta perseris kete histori procedurale, por deshiron qe ti theksoj vetem disa pika kyge sa i perket qellimit:
 - a. Neni 346 i KPPK-se thote: Gjykatesi [...] i cili, me qellim te perfitimit te kunderligjshem te dobise pasurore per vete ose per personin tjeter ose per ti shkaktuar dem personit tjeter, nxjerr vendim te kunderligjshem, do te denohet
 - b. Qellimi i pershkruar ne nenin 346 te KPPK-se eshte nje nga elementet specifike te vepres penale te Nxjerrjes se Kunderligjshme te Vendimit Gjyqesor. Eshte nje qellim specifik dhe si i tille ai dallon nga format bazike te qellimeve te pershkruara ne nenin 15 te KPPK-se. Neni 15 i KPPK-se i definon dy lloje te qellimit bazik - i drejtperdrejt dhe eventual - qe vlejne te secila veper penale brenda KPPK-se. Qellimi i pershkruar ne nenin 346 te KPPK-se perben nje

element te caktuar dhe te definuar subjektiv te vepres penale te Nxjerrjes se Kunderligjshme te Vendimit Gjyqesor. Perveq qellimit bazik qe vlen per te gjitha veprimet kriminale, kjo veper penale kerkon qe i pandehuri ta kete nxjerre vendimin konkret me nje qellim te caktuar, me nje synim.

- c. Percaktimi faktik ne lidhje me element in e caktuar subjektiv sig definohet ne nenin 346 te KPPK-se, nuk dallon nga percaktimi faktik ne lidhje me elementet tjera. Per kete, qellimi specifik mund te deshmohet ne shume menyra, perfshire permes konkluzioneve logjike qe mund te nxirren nga provat tjera, perfshire provave rrethanore.
20. Kur i referohemi pikave kyge te elaboruara me lart, kolegji konkludon se neni 346 i KPPK-se nuk eshte shkelur ne nderlidhje me percaktimin e qellimit. Kolegji ve ne dukje te dyja gjykatat e kane percaktuar si duhet nje nga qellimet specifike te pershkruara ne nenin 346 te KPPK-se. Sig eshte elaboruar me lart, nuk ka qene shkelje e ligjit penal per ta bazuar percaktimin e ketij element! specifik ne prova rrethanore. Per kete, sa i perket ketij aspekti, pretendimet jane te pabazuara.
21. Perveg adresimit te pretendimeve te ngritura nga te pandehurit, kolegji e gjen vendimtare qe te shtoj me sa vijon ne lidhje me qellimin: Duke u bazuar ne faktet e percaktuara nga Gjykata e Qarkut dhe te konfirmuara nga Gjykata e Apelit, kolegji gjen se kualifikimi adekuat ligjor i ketyre fakteve eshte se te pandehurit i kane nxjerre vendimet konkrete jo vetem me qellimin qe te shkaktojne dem, por gjithashtu per te siguruar perfitim te kunderligjshem te dobise pasurore per personin tjetër. Duke i nxjerre vendimet dukshem te gabueshme dhe qartazi te kunderligjshme, te pandehurit ne ate moment ishin mjaft mire ne dijeni mbi pasojat ligjore, domethene qe nje person tjetër do te siguronte perfitim te dobise pasurore dhe se nje personi tjetër do ti shkaktohet dem. Megjithate, pasi qe modifikimi i dispozitivit sa i perket kesaj nuk do te ishte ne dobi te te pandehurve, kolegji e kufizon veten ne cekjen e kesaj shkelje je sipas nenit 438 (1.3) dhe (2) te KPP-se.

"Drejtesia selektive":

22. **T.M., O.J. dhe Sh. Sh.** pohojne se Gjykata e Apelit e ka zbatuar ligjin "ne menyre selektive" kur jane liruar vetem xxx e shkalles se dyte. Fillimisht, kolegji ve ne pah se argumentet ne lidhje me kete jane jashtezakonisht te paqarta pasi qe ato nuk mbeshteten nga asnje baze ligjore. Per me leper, kolegji ve ne dukje se nuk eshte shkelje as e procedures penale dhe as e ligjit material qe te lirohen vetem disa nga te pandehurit, duke u bazuar ne vleresime te ndryshme te fakteve te percaktuara. Kolegji, ne paragrafet 11—14, i ka percaktuar mangesite e aktgjykimit te Gjykates se Apelit, ne lidhje me pjeset permes te cilave disa nga te pandehurit jane liruar. Kolegji nuk ka gjetur se keto mangesi ishin rezultat i gjykates se anshme apo qe ligji qellimisht eshte zbatuar ne menyre selektive. Per shkak te kesaj, pretendimet jane te pabazuara.

Seanca e dates 3 shtator 2014

23. **T.M. dhe S.M.** pohojne se Gjykata e Qarkut ka here shkelje thelbesore te dispozitave te procedures penale duke e mbajtur seancen me 3 shtator 2014 pjeserisht ne mungese te pandehurit **F.B.**. Perverg kesaj, **T.M.** kerkon nga Gjykata Supreme qe te percakton se gfare ka ndodhur gjate seances, duke i ekzaminuar video dhe audio-incizimet, nga ajo seance.

24. Se pari kolegji vendosi ta hedh poshte kerkesen e **T.M.** qe Gjykata Supreme duhet ta ekzaminoj video dhe audio-incizimin nga seanca e dates 3 shtator 2014. Kjo per shkak se nuk ekziston ndonje mundesi procedurale per ta miratuar nje kerkesa te tille. Procedure e Gjykates Supreme kur i shqyrton kerkesat per mbrojtje te ligjshmerise, udhehiqet nga nenet 418 dhe 432—441 te KPP-se. Asnje nga keto nene nuk perfshine mundesine procedurale qe Gjykata Supreme ta marre prova te reja apo te ekzaminoj video apo audio-incizime nga seancat e Gjykates se Qarkut. Per kete, kerkesa e **T.M.** eshte hedhur poshte.

25. Se dyti, kolegji pajtohet plotesisht me Gjykatën e Apelit se nuk mund te nxirret nga procesverbali qe **F.B.** u largua nga seanca me 3 shtator 2014. Megjithate, kolegji gjithashtu deshiron te potencoj se edhe nese kjo do te ishte e vertete, nuk do te shpinte tek propozimi i te pandehurve, pasi qe i pandehuri, te drejtat e te cilit gjoja se jane shkelur, tani eshte i liruar. Rrjedhimisht, shkelja e mundshme e te drejtave te tij nuk ka ndikuar ne te drejten e tij per nje gjykim te drejte.

Provat e falsifikuara:

26. **S.M. dhe Sh. Sh.** pohojne se Gjykata e Qarkut ka falsifikuar prova sepse ne aktgjykime eshte deklaruar se kurrfare njoftimi mbi pretendimin mbi pronesi nuk i eshte dorezuar AKM-se. Fillimisht, kolegji ve ne dukje se pretendimi sa i perket kesaj eshte i paqarte, pasi qe nuk mbeshetet nga asnje baze ligjore apo shembull. Se dyti, kolegji nuk mund te vleresoj percaktimin e fakteve nga ana e Gjykates se Qarkut pasi qe neni 432 (2) i KPP-se i ndalon argumentet qe - drejtperdrejt ose jo drejtperdrejt - e sfidojne percaktimin faktik. Per shkak te kesaj, dhe per shkak se kolegji nuk ka gjetur asnje indikacion te asaj se gjykatat kane falsifikuar prova, keto pretendime jane te pabazuara.

Imuniteti:

27. Pretendimet ne lidhje me shkeljen e Kushtetutes jane ngritur nga **S.M. dhe Sh.Sh.**. Sa i perket kesaj, kolegji pajtohet plotesisht me arsyetimin e Gjykates se Apelit se Kushtetuta iu jep xxx imunitet vetem per veprimet brenda fusheveprimit te funksionit te tyre si xxx, perveq veprave penale te kryera nga ta. Neni 107 (2) i Kushtetutes pershkruan se xxx nuk gezojne imunitet dhe mund te shkarkohen nga funksioni nese e kane shkelur ligjin me qellim. Ne kete rast, te pandehurit jane shpallur fajtor per shkelje te qellimshme te ligjit. Per ate arsye, Kushtetuta nuk e perjashton pergjegjesine penale. Per kete, pretendimi se eshte shkelur Kushtetuta eshte i pabazuar.

Shqiptimi i ndëshkimeve shitesë:

28. **S.M. dhe Sh.Sh.** pohojnë se shqiptimi i ndëshkimeve shtesë është i kundërligjshëm. Kolegji ka konkluduar se ky pretendim është i pabazuar. Ndëshkimi shtesë i Ndalimit të Ushtrimit të Profesionit, Veprimtarisë ose Detyrës, sipas nenit 57 të KPPK-së, mund të shqiptohet ndaj një kryesi të veprës penale, nëse ai/ajo ka keqpërdorur pozitën, aktivitetin apo detyrën e tij/saj në mënyrë që të kryej një vepër penale apo nëse ekziston ndonjë arsye që të pritet se ushtrimi i profesionit, aktivitetit apo detyrës së tillë mund të keqpërdoret për të kryer një vepër penale. Dispozita nuk e bënë dallimin ndërmjet të pandehurve që janë xxx dhe të pandehurve tjerë. Në këtë rast, të pandehurit qartazi kanë keqpërdorur pozitën e tyre në mënyrë që të kryejnë veprat penale konkrete. Për këtë, pretendimi se shqiptimi i ndëshkimit shtesë është i kundërligjshëm, është i pabazuar.

Forma dhe përmbajtja e aktgjykimeve:

29. **S.M. dhe Sh.Sh.** pohojnë se aktgjykimet janë në shkelje të nenit 370 të KPP-së. Ato të dyja kanë argumentuar gjerësisht mbi këtë çështje.

30. Siç u përmend më lart, neni 432 (2) i KPP-së qartazi e përshkruan se një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të parashtrohet mbi bazat e përcaktimit të gabueshëm apo jo të plotë të situatës faktike. Ky kufizim i ndalon të gjitha argumentet që – në mënyrë të drejtpërdrejt apo jo të drejtpërdrejt – e sfidojnë përcaktimin faktik. Kolegji gjen se kjo ndalesë vlen për të gjitha argumentet që deklarohen se arsyetimi është kontradiktor me provat apo që gjykatat i kanë përcaktuar gabimisht faktet materiale. Për këtë, këto argumente janë të pabazuara pasi që ato bien jashtë rrezes së shqyrtimit të kolegjit.

31. Sa i përket argumenteve që ndërlidhen me formën dhe përmbajtjen e aktgjykimeve, kolegji, në paragrafët e mësipërm 11—14, ka konkluduar se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk i përmbush kushtet e paraqitura në nenin 370 të KPP-së, në pjesët përmes të cilave disa nga të pandehurit janë liruar. Në pjesët që ndërlidhen me palët e këtij rasti që e kanë bërë kërkesën, kolegji ka konkluduar se pretendimet janë të pabazuara dhe se aktgjykimet i plotësojnë kushtet e paraqitura në nenin 370 të KPP-së.

32. Sa i përket aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, kolegji fillimisht vë në dukje se dispozitivi në lidhje me shqiptimin e ndëshkimeve shtesë tashmë ishte modifikuar nga Gjykata e Apelit. Për këtë arsye, do të ishte e tepërt për kolegjin që ta adresoj këtë çështje. Kolegji nuk pajtohet që dispozitivi është në kundërshtim me vetveten, dhe arsyetimi në lidhje me N.U. dhe faktin se ai ishte i vetmi që është dënuar për veprën penale në bashkëkryerje. Për më tepër, nuk është domosdoshmëri për gjykatën që ti adresoj të gjitha argumentet e ngritura në deklaratat përfundimtare. Si konkluzion, kolegji gjen se të gjitha pretendimet ndaj formës dhe përmbajtjes së aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, janë të pabazuara në këto pjesë.

33. Sa i përket aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, kolegji tashmë i ka adresuar disa mangësi të caktuara në lidhje me të pandehurit që janë shpallur të pafajshëm. Në lidhje me të pandehurit që kanë bërë kërkesat në këtë rast, situata megjithatë është e ndryshme, pasi që Gjykata e Apelit i ka afirmuar konkluzionet tashmë të elaboruara gjerësisht nga Gjykata e Qarkut. Në situatat ku Gjykata e Apelit pajtohet me arsyet tashmë të dhëna në shkallën e parë, standardi për arsyetimin e tyre është më i ulët. Kolegji nuk pajtohet që arsyetimi është i pamjaftueshëm apo që dispozitivi është i paqartë apo i pakuptueshëm. Si përfundim, kolegji gjen se të gjitha pretendimet ndaj formës dhe përmbajtjes së aktgjykimit të Gjykatës së Apelit janë të pabazuara në këto pjesë.

V. KONKLuzionET

Pas shqyrtimit të asaj që qendron më lart, Gjykata Supreme vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Me këtë përfundim, kolegji nuk gjeti ndonjë arsye që ta shtyj apo nderpres ekzekutimin e

aktgjykimeve.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PRISHTINË
PML.KZZ 236/2016, data 11 janar 2017**

Gjyqtarja kryesuese:

Procesmbajtësja:

Valdete Daka
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Maja Mähl
Zyrtare Ligjore e EULEX-it

Anëtarët e kolegjit:

Elka Filcheva—Ermenkova
Gjyqtare (Raportuese) e EULEX-it

Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

